

Skënder Demaliaj

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Tiranë

BJESHKA E SYLBICËS NË KËNGËT E BYTYÇASVE

Për bjeshkën, populli ka shkruar shumë këngë: *Bjeshkët e mia, Kujto bjeshkën ku je rrit, Mora bjeshkën përpjetë, Më koftë haram bjeshka pa ty, Pranverë në bjeshkë, Ti, moj bjeshka e Tropojës, Ti, moj bjeshka e Sylbicës, Bjeshkët e Rugovës, Pse po dridhen bjeshkët tona, Të dalim në bjeshkë te mrizi, Boll e mira si e more bjeshkën, Bjeshkët e Shalës kanë lidh besën, Bukuritë që s'lanë me u plak, Kush m'i mori bjeshkët e mia etj.*

Bjeshkët me bukuritë e tyre mahnitëse, magjepsëse i kanë frymëzuar edhe poetët të shkruajnë vargje: “*Bjeshkët e mia/ Jetëshkrim i përjetshëm/ Dashuria ime*”, “*Bjeshka/ Gëzohet me pranverën*”, “*Bjeshkët/ Shkundin çarçafin e bardhë/ Qingjat lodrojnë*”, “*Mbi Majën e Hekurave/ Agu i mëngjesit/ Përkundet me bjeshkët*”, “*Bjeshka buzëqesh/ Luledelet harlisen/ Bjeshka vikat majave*”, “*Erdh mëngjesi/ Shtegut të bjeshkës/ Ecën dielli*” etj¹.

1. Bjeshka e Sylbicës - vështrim i përgjithshëm

Rrugës kur shkon për në Sylbicë kalohet në tri zona:

- Zona e Dushkut, e cila shtrihet në lartësinë 500-800 metra mbi nivelin e detit dhe paraqitet mjaft e degraduar (Pac - Lugu i Zi - Ara e Osës).
- Zona e Ahut në lartësinë 800-900 metra mbi nivelin e detit (Ara e Osës – Rrasa e Poshtër).

¹ Gjon Neçaj, *Haiku i bjeshkëve* (Elbasan: Egnatia, 2009), f. 31-51.

- Zona e Kullovave Alpine shtrihet mbi Zonën e Ahut deri në lartësinë 2300-2400 metër mbi nivelin e detit (Rrasa e Poshtë – Gusan – Gjerovicë).

Pllaja e Sylbicës ndodhet mbi 1800 metra mbi nivelin e detit. Ndahet në tri zona: Rudina e Madhe, Zona e Lkenit të Verdhë, Hudhra e Butë. Ajo kufizohet: në veri me Dobërdolin, në verilindje me Vokshin (Qafa e Ali Çelës), në lindje me Ujezën, Kershin e Brovinës edhe Zapllaken, në jug me Rreshkëzën dhe Pojanën. Në perëndim – Koritat e Gashit edhe Përbuja. Gusani, me Gjerovicën (maja më e lartë e tij), e cila e ndan me Kosovën.

Mespërmas bjeshkës kalon lumi i Sylbicës; me ujë të bollshëm e të rrëmbyeshëm. Ai kalon nëpër Tropojë-Sopot-Dizdar, ku bashkohet me Valbonën dhe së bashku derdhen në Dri. Para vitit 1990 në vendin e quajtur “*Danat e Sylbicës*” ishte vendosur një central elektrik, me të cilin furnizohej me dritë elektrike posta e kufirit, baxhoja e një pjesë e staneve. Sylbica ka ujë të bollshëm për të pirë njerëzit dhe bagëtia, ndryshe nga bjeshka e Radeshës apo ndonjë tjetër, ku bjeshkatarët shkrijnë borë në enët e ujit për ta siguruar atë. Dallohen: Gurrat e zeza, në ujin e të cilave mund ta mbash dorën vetëm pak sekonda. Nga ftohtësia është formuar një shtresë lëmyshku dhe uji duket si në ngjyrë të zezë.

Në Sylbicë janë Buja e Shtjerrave (grumbullohen qengjat kur ndahen nga delet), Qukat e Gashit. Po kështu është Kërshi i Elez Kurtit. Aty ndodhet një varr, poshtë tij është Lkeni i Popocit, më sipër Hurdha e Butë, Kroni i Hurdhës së Butë, ku pushojnë njerëzit që vijnë nga Tropoja për në Përbejë. Në krahun e djathtë të Hurdhës së Butë janë Podet e Epëra, poshtë tyre Podet e Poshtme. Qafa e Sylbicës është 2142 metër mbi nivelin e detit, Maja e Gusanit 2539 metra, Maja e Gjerovicës 2656 metra. Në Gjerovicë është Lkeni i Madh dhe Lkeni i Vogël i saj. Nga Gjerovica shihet Maja e Koritave, 2387 metra, Maja e Zezë, 2400 metra, Shkëlzeni 2402 metra. Në horizont shihet maja e Korabit. Midis Gjerovicës dhe Qafës së Ali Çelës në hyrje ka gurë të kuq dhe në këtë zonë rrallëkush ka shkelur. Kur ecën të duket se je mbi sfungjer.

Në territorin Dobërdol-Sylbicë janë 15 liqene, në Sylbicë janë 8 liqene. Liqenet akullnajore të Sylbicës janë me gjatësi 1000-1500

metra, gjerësi 100-250 metra dhe me sipërfaqe 40 hektarë. Këto liqene ndodhen në lartësinë 1900 metra mbi nivelin e detit. Kanë ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrijnë në sipërfaqe. Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike) dhe estetike. Janë monumente natyrore. Populli i quan “*lkej*”. Buzë tyre bagëtia mrizojnë dhe pinë ujë. Dallohen: Lkeni i Madh (quhet kështu se është më i madhi si sipërfaqe, tre hektarë, në lartësi 2082 metra mbi nivelin e detit), Lkeni i Verdhë (jeshil nga llumi dhe bytyçasit ngjyrën e verdhë e përdorin për ngjyrën jeshile), Lkeni i Dashit (në të u mbyt fillimisht dashi dhe për ta shpëtuar atë shkuan në ndihmë djali dhe vajza, të cilët u mbytën edhe ata. Legjenda thotë se fyelli i djalit doli te Vrella e Shoshane, shumë kilometra larg tij). Lkeni i Dashit nuk furnizohet nga ndonjë burim, por as nuk derdhet kund. Ndodhet mbi 2000 metra mbi nivelin e detit. Lkeni i Shkaut (sipas gojëdhënave aty gjenden varret e tre vëllezërve me origjinë nga Serbia. Ata kishin vendosur të qëndronin gjatë dimrit në bjeshkë, kishin siguruar ushqimet, drutë e zjarrit për ngrohje, por vdiqën nga frika, nga gjënimet e bjeshkës, siç shkruanin në një letër që e kishin gjetur pas vdekjes së tyre. Në pranverë u gjetën të vdekur dhe u varrosën në afërsi të liqenit, duke i dhënë edhe emrin atij - “*Lkeni i Shkaut*”). Në Danaj është Lkeni i Danajve, me formë të çrregullt, ka derdhje në Prronin e Danajve. Rrethohet me *kërsha* e bimësi, sidomos boronica.

Vera në Sylbicë është: diell gjatë ditës dhe freskët gjatë natës. Ndizet zjarr për ngrohje dhe njerëzit gjatë kohës së fjetjes përdorin mbulesa të trasha. Herë pas here pasditeve bie shi që shoqërohet me breshër. Në fund të gushtit në Sylbicë bie dëborë. Njerëzit dhe lopët, kuajt, dhitë ulen nga bjeshka javën e fundit të gushtit, kurse barinjët me tufat e tyre të deleve mund të qëndrojnë edhe gjatë muajit shtator. Jo në pak raste stuhia dhe bora rrezikojnë uljen e tyre. Kafshët e egra më të zakonshme janë: ujku, dhia e egër (në Gusan), ariu. Nga zogjtë dallohen: shqipja dhe korbi. Në Gjerovicë është Kërshi i Shqipes, në formë shpelle me përmasa 15 m (gjatësia) 15 m (gjerësia) dhe 7 m (lartësia). Shqiponjat janë të shumta dhe të mëdha. Gjatë ditës ato fluturojnë mbi territorin e Sylbicës, duke e mbajtur nën vëzhgim dhe kontroll, me qëllim sulmi për të siguruar ushqimin. Bytyçasit tregojnë gjëra interesante dhe të çuditshme për shqiponjat: rrëmbime nga ana

e tyre, të qengjave e kecave të vegjël. Sa janë të besueshme?!... Gjithashtu ka shumë shpella të tjera: Shpella e Kuqe, e Gusanit, e Kërshit të Zi, e Kërshit të Elez Kurtit, e Agës. Në Shpellën e Kuqe dhe të Gusanit, sipas gojëdhënave gjenin strehë Zanat e Malit. Natën kur lëviznin ndriçonin vendin.

Ekonomia e bytyčasve e mirëqenia e tyre ishin të lidhura ngushtë me Bjeshkën e Sylbicës. Vendin kryesor si sektor e zinte blegtoria. Këtë e vërejtë edhe populli që la fjalën “*malësori shkon mbas bishtit të dhenit*”². Mungesa e ujit për ujitjen e bimëve bujqësore dhe për bagëtinë, thatësira e madhe dhe e gjatë e bënte të domosdoshme daljen në bjeshkë. Në të kundërt do të rrezikohej numri i krerëve, do të pakësohej bulmeti. Tregtia e mishit, e leshit, e djathit, e gjalpfit e gjizës ishte jetike për të ardhurat e bytyčasve. Edhe dimrin e kalonin më lehtë dhe e përballonin më me sukses bagëtia që veronin në bjeshkë.

2. Bjeshka e Sylbicës në këngët e bytyčasve – Analizë dhe komente

Bukuritë e rralla të Bjeshkës së Sylbicës nuk i kanë shpëtuar syrit të këngëtarit popullor. Ai pa u zgjatur shtron pyetjen:

“Cila bjeshkë t’doket ma e mira?

Dobërdoli a Koshutica?

Më shumë vjamë po ndon Sylbica”.

Pra, Sylbica është një bjeshkë e shëndetshme për njerëzit, në mënyrë të veçantë për vajzat dhe gratë, si edhe për bagëtinë.

“Ku don çikë me bjeshkue?” – e pyesin. Përgjigja e saj:

“N’Sylbicë nanë due me verue,

Me ujë të ftohtë me u fladue,

Me tamël sykash me u zbardhue”...

Ndihet fyelli i çobanit (i djalit të ri), kënga e vajzës që është pranë tij. Stanet, torishtat e bagëtive ngjitet me to, shtrunga ku milen delet e lopët – janë elemente të rëndësishme të këtyre këngëve. Kjo vihet re

² Rrok Zojzi, *Ndamja krahinore* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2020), f. 72.

që në titujt e tyre: *Moj e bukur, si e more bjeshkën!...*, *Boll e bukur, çikë, n' at' stanishtë!*, *Boll e bukur, n' derë të stanit!...*, *Moj e bukur si del në shtrungë...*

2.1. Dashuria e vajzës me djalin zë vendin kryesor në këto këngë

Ashtu siç çelin e rriten lulet në pranverë, çel dhe rritet dashuria. Malli është i madh kur djali dhe vajza nuk janë takuar me njëri-tjetrin për shumë kohë, pasi njëri ka qenë në bjeshkë, kurse tjetri në vërri (në shtëpinë e përherhme). Minuta iu duket atyre ditë, kurse ditët vite. Shkaku: dashuria është e madhe dhe nuk mund të rrinë pa u parë e pa u takuar me njëri-tjetrin. “*Shumë vonova pa ra n'vrrri,*

o gojfil i malit.

S'u vonova, po të duket ty,

o moj lulja e allit”.

Bjeshka me bukuritë dhe karakteristikat e saj: rudinat plot bar të njomë, liqenet që e rrethojnë, burimet me ujë të pastër e të ftohtë, qengjat që kullosin dhe kërcejnë nga shëndeti i mirë, tingëllima e *kumonave*. Karvani i bjeshkës zë një vend të rëndësishëm në këto këngë. Ajo sjell frymën romantike, veçori e këngës erotike. Populli në këtë mënyrë me këngën e vet shpreh qartë mesazhin e tij: gjithçka gëzon, natyra, kafshët, njerëzit kur dashuria në mes të njerëzve është e pastër, e çiltër, e qëndrueshme. Për ta bërë këngën më intime dhe për të shprehur ndjenjën e lartë të dashurisë përdoren shprehjet: “*O gojfil i malit*”, “*O moj lulja e allit*”. (Ngjyra e allit është ngjyra e kuqe). Ngjyra e kuqe simbolizon dashurinë. Bytyçasve në bjeshkë fytyra u merr ngjyrë të kuqe të ndezur.

Këto këngë shprehin me ngrohtësi, emocion dhe elegancë të madhe ndjenja të fuqishme të një dashurie të pastër, të sinqertë, duke zbuluar kështu virtytet e larta të popullit tonë³.

Në të gjitha këngët përdoret epiteti *e bukur*, për të vënë në pah bukurinë e vajzave, të cilat e hijeshojnë dhe e zbukurojnë akoma më shumë bjeshkën. Në derë të stanit rri vajza, e cila mendon, mediton dhe kujton djalin, i cili ka qëndruar në vërri për të kryer punët e

³ Zini Sako, *Këngë popullore dashurie* (Tiranë: Instituti i Folklorit, 1965), f. 3.

stinës, por është edhe ushtar. Kur merr leje ai fluturimthi del në bjeshkë dhe takon vajzën. Gëzimi është i madh. Nuk përmbahen - rrokin dhe përqafojnë njëri-tjetrin, i japin *gajret* njëri-tjetrit me shpresën se koha e ushtrisë do të kalojë shpejt e ata do të jenë përsëri bashkë.

Vajza punon me gëzim për pajën dhe veshjen e *jaranit* (të dashurit). E shpreh me vargjet:

*“Lumja unë t’ kujat i kam,
I kam t’ jaranit, s’ m’ shkojnë dam.
I kam t’ jaranit, të djalit t’ ri.”*

Shqetësimi i vajzës për të dashurin është prezent gjatë gjithë kohës. E për të mos u lagur djali nga shiu i verës, ajo sakrifikon veten: flokët e saj të gjatë, të kuq e të dendur janë umbrella e djalit. Aroma e vajzës i largon edhe të ftohtët... Momenti është tepër romantik, i ndjeshëm dhe intim:

*“Ja ka nis një rig shi,
Qyqja Dada ç’ka t’ban ty,
Flokët e kuqe t’i qes përmbi,
Nuk ta la pikën me hi,
Me kujtoftë se je brenda n’shpi.
Kurrë nuk çartet Dada me ty”.*

Vargu i fundit shpreh besnikërinë ndaj dashurisë. në këtë këngë vihet re një veçori dalluese: djali dhe vajza deklarojnë se nuk do të prishen me njëri-tjetrin, dashuria e tyre do të jetë e përjetshme (përdorimi i ndajfoljes: kurrë). E s’ka si të ndodhë ndryshe kur në themel të saj është sakrifica, është përkushtimi për njëri-tjetrin, të kuptuarit e njëri-tjetrit, përpjekjet e qëllimet e përbashkëta për një jetë dinjitoze, të bazuar në parime e ideale të larta morale. Ky varg të kujton edhe betimin e kreshnikëve.

Kënga e djalit, e shtëna e pushkës së djalit, zëri i tij, tërheqin vëmendjen e vajzës, të ngujuar në shtëpi. E dashuria është kaq e madhe sa ajo nuk mund të mbahet brenda dhe shpërthen, pa marrë parasysh pasojat: ndëshkimin fizik. Një situatë të tillë nuk mund ta durojë edhe djali. Ai s’e komandon veten, sjellja dhe qëndrimet e tij bëhen agresive. Veprimin e tij e miraton, në heshtje, edhe vajza. Ajo

nuk do që i dashuri i saj të jetë *merhum*, të mos jetë i zoti të *nxjerrë qimen nga qulli*. Ajo do të jetë çapkën, i guximshëm, cub në kuptimin e mirë të fjalës.

Në këtë mjedis të ashpër nga natyra, nga sjellja e mentaliteti i njerëzve, deri në njëfarë mase është i pranueshëm, një reagim i tillë:

*“Ku ke lulë kur knova,
N’vek kesh e vesh të mora,
Me dalë jashtë nuk guxova,
S’mund u ndala e një fjalë e fola,
Thash të vogël të lumtë goja,
Grusht e shkelma i fitova.
Kur na erdh flaka te kulla,
Dilni jashte a jini burra?!
Qai djalë fare po u qet!”*

Dashuria është diçka sublime. Ajo duhet ruajtur, pavarësisht nga sakrificat dhe haraçi që mund të paguhet.

Vajza është gati të bëjë çdo sakrificë kur dëgjon zërin e tij. Çohet nga buka pa u ngopur, del nga veku ku po punon, del në oborr, lë çdo punë përgjysmë. Kënga e tij e frymëzon, zëri i tij piskamë i jep forcë për të vazhduar më tej punët e nisura, për t’i përfunduar me cilësi e në kohë. Ajo dëshiron të vdesë përnjëherë me djalin, t’i kenë varret afër njëri-tjetrit, të jenë bashkë edhe në botën tjetër, siç qenë në botën reale. Ka caktuar edhe vendin, ku t’i kenë varret: nën *bojli*, në hije, në freski, aty ku mrizojnë bagëtia. *Bojlia* (lloj qershie) lulëzon dhe i pjek frutat në pranverë, atëherë kur lind dhe lulëzon dashuria. Nuk harron edhe qyqen: t’u këndojë mbi varr që të tërheqë vëmendjen e të gjallëve, të flasin dhe të kujtojnë dashurinë e pastër të tyre. Thirrja: *“Ishalla desim të dy përitheri/ Ishalla desim për një natë”* – është besa që i kanë dhënë njëri-tjetrit për përjetësinë e dashurisë së tyre. Vajza nëm (mallkon) me gjithë shpirt e zemër ata që përhapin fjalën se vajza e djali janë ndarë:

*“Kush ka thanë se jena çartë?!
I madhi Zot, goja ju thaftë,
Ju thaftë goja, ju baftë shkrum,
Se na t’dy s’çartena kurrë!”*

Karakteri ëndërrimtar dhe karakteri natyralist i këtyre këngëve janë dy çështje që lidhen ngushtë me traditën e shoqërisë shqiptare. Duhet thënë se më shumë është ëndërruar për dashuri sesa është përjetuar konkretisht. Së këndejmi del çështja se “*mllëfi*” kundër ndalesave të ndryshme ka ndikuar edhe në art, herë-herë të shpërthejë në mënyrë të pamatur, të shkohet në ekstremitet. Kur s’lejohet të shijohet fare dashuria, atëherë të kërkohet gjithçka⁴.

Vajza krahasohet me zanën. Ato sipas gojdhënave të kahershme të bjeshkatarëve e kanë shtëpinë në Gusan. Dalin dhe bëjnë dritë natën. Mallkojnë njerëzit e ligë dhe bekojnë njerëzit e mirë. Për bytyçasit bjeshka është e bekuar, e shenjtë. U sjell shumë të ardhura, shëndet, mirësi dhe dashuri. E shpreh edhe vetë titulli i këngës: *Mori bjeshkë t’lansha bekue!*

*“Mori bjeshkë t’lansha bekue,
Shumë sevdanë ma ke dhanë mue,
Gurë e n’gurë tuj u freskue,
Majë n’ maje tuj këndue,
Tuj gjujt shenj e tuj lodrue.”*

Pra, kudo në bjeshkë zotëron një atmosferë festive gëzimi. Kjo shprehet gjatë gjithë kohës: edhe kur ngjiten në bjeshkë, edhe kur ulen nga bjeshka, edhe kur organizojnë gostinë e bjeshkës. Qengjat që lodrojnë nga shëndeti, *kumona* e dashit, vizitat te njëri-tjetri - e gjallërojnë dhe e zbukurojnë bjeshkën. Në këngë pasqyrohet veprimtaria e përditshme e bjeshkatarëve: Kullosin bagëtinë, i mjelin në shtrungë, zënë bulmetin, qethin delet, punojnë në vek, këndojnë e i bien fyellit, presin miq, drekojnë në rudina, te Gurra e Zezë, buzë liqeneve, afrojnë bagëtinë te mrizi, u qesin kripë në gjollë.

Ka edhe mërztitje, qejfmbetje se djali e vajza janë të ndarë nga njëri-tjetri. Njëri është në bjeshkë e tjetri në vërri. Vajza tërheq vëmendjen se djali nuk po sakrifikon sa duhet për të shkuar në bjeshkë edhe pse ai ka punë e bjeshka është larg. Dashuria kërkon edhe sakrifica.

Nënat tregojnë kujdes të veçantë për vajzat e tyre që të jenë të shëndetshme. Duke qenë të tilla bëhen edhe më të bukura, më tërheqëse, më të kërkuara nga djem të pashëm e familje të pasura e të

⁴ Rustem Berisha, *Vëzhgime për poezinë popullore* (Prishtinë: Rilindja, 1987), f. 120.

njohura për t'i marrë nuse. Ua lajnë sytë me ujë të nxehtë, ua fshijnë me faculetë, u japin bukë të rreshkët (të thekur), me kajmak. Kështu i plasin në bark djemtë derisa marrin fjalën e tyre për martesë.

Bjeshka gjëmon, lumi gjëmon shumë më tepër si shenjë zemërimi kur pengohet vajza për t'u martuar me djalin që dashuron. Zemra e saj rreh pa pushim për djalin. I quan *burg të zi* ditët e izolimit prej tij. Lotët e saj: *si shiu prej reje* shprehin dhimbjen e saj.

Dashuria dhe pengesat (malli i hap rrugë dashurisë, ai ulet, bie para forcës së dashurisë), lulet çelin, mali digjet, kallet, gjethet pikojnë të këputura, jo nga vjeshta, por nga ndjenjat. Në rrugën e realizimit të dashurisë, në vend të fuqive natyrore del si pengesë një fuqi tjetër - njeriu. Ky bëhet edhe shkëmb rezistence, edhe lumë i pakalueshëm apo mal i madh⁵.

Çobani, i dashuri i vajzës, është i ndjeshëm, jo vetëm ndaj vajzës, por edhe ndaj bagëtive që i kullot e kujdeset për to. As lëndimin e vajzës nuk e toleron dhe nuk e duron, por as lëndimin e deleve që i ruan në rudina. Vajza e di këtë, prandaj kujdeset shumë për tufën, por në punë e sipër, kur i mjel edhe i lëndon ato me unazën e saj, por thotë se "*m'nëm*" (më mallkon) pa zemër e nuk *m'ngjiten* mallkimet e tij se mbi gjithçka prevalon dashuria midis tyre dhe ajo nuk cenohet për gjëra të vogla.

Kur njerëzit janë në bjeshkë, kjo ka gjallëri. Kur largohen ata fillojnë shirat, gurrat shtojnë ujin, egërsirat afrohen, dhitë e egra ulen poshtë. Shpresa për të shkuar në bjeshkë vit për vit i mban gjallë ëndrrat e të rinjve për t'u takuar atje përsëri. Ka një specifikë jeta në bjeshkë, krahasuar me jetën në vërri. Stanet, ndryshe nga shtëpitë, janë pranë e pranë, kullota në vërri është e ndarë sipas fshatrave, kurse në bjeshkë është e përbashkët. Kjo krijon mundësi reale për t'u takuar më shpesh djali me vajzën. Përveç kësaj bjeshka i bën vajzat si *piskavica*, gratë si pjepra, djemtë *kapreçë* (më të shëndetshëm, të mbajtur mirë e të gatshëm për trimëri).

2.2. Personazhet kryesore të këtyre këngëve janë: baresha dhe bariu. Lidhet me vetë zhvillimet ekonomike në këtë zonë, me

⁵ Nuhi Vinca, *Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës* (Shkup: Flaka e vëllazërimit, 1992), f. 56.

vendin parësor që kishte sektori i blegtorisë. Bytyçi është i njohur për livadhet dhe kullotat e tij.

Portreti i vajzës bytyçase është dhënë duke u mbështetur në këngët e kreshnikëve, ku si model shërben bukuria e Tanushës. Është me flokë të gjatë, e bardhë, me quka në faqe, me qafë të gjatë, me faqet si simite Gjakove, me gojën si kuti, hundën si kalem, syrin si filxhan, vetullën të hollë si gajtanli, ballin si dukat. Vargjet:

“T’duket qafa gastarli,

Ta shoh ujët kur e përbi.” - janë vargje lapidar të lirikës erotike shqiptare.

Uji i bjeshkëve, i lumenjve, i tejdukshëm – qafa e vajzës e tejdukshme. Gjithçka transparente... edhe dashuria.

Vajzën e gjejmë te stani, te pojata (vend ku strehohen bagëtia e imët), te zabeli, te burimi i ujit, duke mbushur bucelën, me tufën e bagëtive duke i kullotur. Kur ecën ajo dridhet rruga, mali, hijeshohet vendi. Është e shëndoshë, e bukur dhe krenare. Për bytyçasin gruaja e shëndoshë është edhe e bukur. Shëndeti të bën të bukur, të aftë për punë, të kthjellët në mendime e gjykime. Jo në pak raste ne gjejmë vargun *Moj e mira këmbët e trasha*. Këmba e mbushur, e gjatë dhe e drejtë – është një nga kërkesat kryesore që duhet të ketë një vajzë apo grua e bukur. Veshja karakteristike, për vajzën bytyçase, është *pshtjellaku*, i punuar mirë, i qëndisur me kujdes. Aty duket sa punëtore dhe e vyer është ajo, si harmonizohet bukuria e saj me bukurinë e veshjes:

“Moj e mira n’atë zabel,

Vesh pshtjellakun kacubel,

Kacubel e gurra-gurra,

Ka t’shkojsh ti dridhet udha

Dridhet udha, dridhet mali,

Dalngadalë po t’thurret djali,

Grahu lopëve prej këtij mali,

S’t’kam pa moti, m’ka marrë malli”.

Porteti i djalit: Është djalë i mirë dhe i ri, i bie fyellit për bukuri, është këngëtar dhe instrumentist, t’i luan mendtë *me e pa me sy*. Ka pushkë e allti, është qitës i mirë, trim e i guximshëm, besnik, nuk e përgojon dashurinë e tij me vajzën, zëri i tij i fortë piskamë, i

përkushtuar në dashurinë për vajzën dhe i gatshëm për të bërë çdo sakrificë.

Takimet e vajzës me djalin janë në verë (pas shpërthimit të dashurisë në pranverë), në rutinë, nën hijen e lisit, të mollës. Takimet janë plot me humor, djali i bie çiftelisë, kurse vajza kërcen (Vallja e Bytyçit është e njohur në gjithë Veriun e Shqipërisë). Dashuria është këngë, valle, gëzim:

*“Moj e mira del në baçe,
Kur po t’shoh zemrën ma knaqe”*

2.3. Semantika leksikore e këngëve:

- Përdorimi i foljeve, të cilat i kategorizojmë si folje që shprehin:

Veprime: *dalin, knon, vikat, qëndis, tue qitë (pushkë), e ndjell delmen, dirgjen nga bjeshka, me u flladit, me verue, me u zbardhue.*

- **Marrëdhëniet e vajzës me djalin:** *Ne nuk çartem kurrë ndër veti, zemra rreh (vetëm për djalin), po t’pret dada, m’u nxiftë bjeshka pa ty, koftë bekue (bjeshka) që e bekon dashurinë e tyre.*
- **Amanete:** *ma ka lënë amanet (burri i parë).*
- **Urime:** *Rritu çikë, ty nana t’pastë! Ishalla desim të dy priheri! Ishalla desim të dy bashkë! Mori bjeshkë t’lança bekue.*
- **Mallkime:** *Ruaju pak, çikë të plaçin sytë! Ju thaftë goja, ju baftë shkrum! I madhi Zot t’dy sytë ia plastë! Djalë m’u nxiftë jeta pa ty! Mue m’u nxiftë, e zeza bjeshkë!*

- Përdorimi i emrave, të cilët shprehin:
 - **Emërtim vendesh:** *bjeshkë, oborr, vrri, shpat, rudina, shtrung, vorret, ashta, mal, livadh, ortek, prrojet, thepa.*
 - **Emërtim bimësh:** *dredhëzat, mjedrat, boronicat, therrat, kaçat, lulja.*
 - **Emërtime që lidhen me blegtorinë:** *çobani, baresha, shtaga, tubat, dhi, dele, shqerrat, tamël, mjelse.*
 - **Emërtime kafshësh:** *shqiponja, qyqja, gjëja e egër, ujku.*

- **Emërtime të pjesëve të trupit:** *sy, qafë, vetull, faqe, cicë, fytyrë.*
- **Emërtime sendesh:** *ujë, letër, gur.*
- **Emërtime që tregojnë kohë:** *mot, verë, natë, vit.*
- **Emra abstraktë:** *exheli, shpresa, dert, dashuria, mall.*
- **Përdorimi i shprehjeve frazeologjike:** *më paske dashtë me kopili (me hile), kurrë nuk çartem bashkë (nuk prishemi), me i plasë në bark (t`i sëmurë rëndë), iu thaftë goja, iu bëftë shkrum, mue krejt m`ka lanë shpresa, hajd bre dadë, mos ki dert (mos u mërzit), trashë e majë i ka bjeshka (i ka shëndoshur).*

2.4. Toponimet:

Sylbica, Dobërdoli, Koshutica, Lkejtë e Sylbicës, Mali i Gusanit, Maja e Gjerovicës, Guri i Metalisë, Rudinat e Sylbicës, Gurrat e Zeza, Bjeshkët e Namuna.

2.5. Koha dhe hapësira

Ngjarjet zhvillohen në periudhën e verës, koha kur bytyçasit dalin në bjeshkë (13 qershor – 25 gusht). Për këtë përdoren emrat: *vera, muajt e verës, gjithë verën, dreka, djergia nga bjeshka*, shprehjet kohore: *tash tri vjet, dy vjet, çdo mot.*

2.6. Elementet etnografike

Gjilpëra dhe veku, me të cilat vajza përgatit pajën dhe *mestet* e djalit, fyelli, të cilit i bie çobani, *kumonët* e deshve, që e bëjnë bjeshkën të zhurmshme, por që edhe tërheqin vëmendjen e vajzës se aty është djali që është duke kullotur bagëtinë, duke i rënë edhe fyellit, kajmaku, ushqim tradicional i përditshëm që u jep shëndet, forcë e bukuri djalit e vajzës, zanat, besa, pushka, mrizi, ku pushojnë bagëtia, unazat, të cilat i mban në gishtat e hollë e të bukur vajza për të paralajmëruar të gjithë se ajo është e dashuruar me djalin dhe pret momentin për ta shpallur atë zyrtarisht. Kështu i paraprin edhe propozimit të ndonjë djali tjetër.

3. Figurat letrare

Figurat letrare janë qelizat e stilit letrar⁶. Figurat letrare bashkëjetojnë dhe bashkëkomunikojnë me njëra-tjetrën dhe janë në funksion të asaj që kumtojnë dhe të mesazheve që përcjellin te dëgjuesi. Figurat duhet të studiohen nga aspekti i karakteristikave që paraqet secila figurë veç e veç, nga kontributi i tyre i përgjithshëm brenda stilit dhe sipas rolit dhe funksionit të secilës veçmas, por edhe sipas rolit dhe funksionit të përbashkët brenda stileve, qofshin ato të individëve apo të periudhave të njohura letrare⁷. Nga këto figura do të veçojmë:

Metaforat, të cilat kanë si qëllim të evidentojnë vetitë më kryesore dhe të prodhojnë imagjinatë:

Djalë m'u nxiftë bjeshka pa ty! Iu thaftë goja iu bëftë shkrum! I madhi Zot t'dy sytë ia plastë! Po rri bjeshka tue gjimue! Po rri bjeshka tue ba gjamë! Është edhe metaforë, edhe paralelizëm figurativ. Bjeshka qan, se vajza është mbyllur në kullë për të mos komunikuar me djalin që e do. Këtë gjë ajo e konsideron baras me vdekjen. Pa djalin nuk ka kuptim jeta e saj.

Djelt' e ri me i plas në bark. Bukuria e vajzës është aq e madhe dhe evidente sa i plas djemtë në kuptimin figurativ, i bën ata të rendin pas saj, me shpresë se do të marrin pëlqimin e saj për martesë.

Hallin e vajzës e kajshin zogjtë.

Paralelizmi figurativ: Te kënga *Çka kanë lulet në Sylbicë?* - lulet kanë tre vjet që nuk mbijnë, rudinat kanë mbetur shkretë, në kullota nuk del *gojlfili*, në thepat e maleve nuk bie fyelli, sepse vajza mbahet në burg të zi (në kullën e saj) nga prindërit fanatikë, që nuk e duan martesën e saj me djalin që e dashuron.

Epitetet: Te këngët e dashurisë epitetet janë më të shpeshta, sepse bukuria dhe ndjeshmëria mes të dashuruarve shfaqet gati gjithëkohore, me anë të përshkrimeve të goditura, të nxjerrjes në pah të cilësive, të virtyteve, ku epiteti ka forcë dhe afinitet të dukshëm të kumtimit:

⁶ Rustem Berisha, *Stili dhe figuracioni i poezisë popullore shqiptare* (Prishtinë: IAP, 1986), f. 132.

⁷ Rustem Berisha, *Vëzhgime për poezinë popullore* (Prishtinë: Rilindja, 1987), f. 98.

Vizatohet bukuria e vajzës: *duar të bardha, bardhoke e bardhë, vetullhollë, faqekuqe, qafëgastare, sytë e zi, hunda e drejtë, të bardhë e të butë gishtat e dorës, qafë e bardhë, goja e vogël, dhëmbë të shpeshtë, këmbët e trasha.*

Veshja e saj karakteristike: *pështjellak i gjanë, këmishë e hollë. Djalë i ri (i ri në moshë, në sjellje, në veprime, në paraqitje, në mendime).*

Burg i zi (izolimim nga djali vajza e quan burg të zi, këto ditë janë trishtim për të, i shkaktojnë stres, depresion dhe ankth).

Bukë të rreshktë i jep nëna vajzës që e ka amanet nga burri i parë, ia lanë sytë me ujë të nxehtë.

Ujë i ftohtë, karakteristikë për Bjeshkën e Sylbicës.

Rudinat shkret (nuk ka gjallëri, kur nuk ka njerëz e bagëti).

Guri i vogël, me të cilin e gjuan djali vajzën kur vjen me leje nga ushtria. Merr gurë të vegjël nga frika se po e vret edhe kjo i shkakton dhimbje.

Krahasimet: Janë marrë mjete nga mjedisi baritor, natyror, nga fusha që janë më pranë djalit dhe vajzës të dashuruar:

Konke ba dadë bash si bishë (rrit e zhvilluar shumë e nga kjo nuk mbahet e nuk ka njeri që i del përpara).

Krejt si ujët si rrjedh në gurë, na u shkojnë lotët si shiu prej reje. Janë edhe hiperbolë, edhe krahasim dhe shprehin një ndjenjë të fortë. Malli që kanë qenë të ndarë për disa kohë është i madh, nuk i ndalin dot lotët. Njeriu qan edhe kur papritur i vjen një gëzim i madh. Vajza gjendet e befasuar nga ardhja e djalit në bjeshkë.

Dirgjen çikat si piskavica, dirgjen gratë si llubinica (pjepri). Zbresin vajzat me delikatesë, kurse gratë të shëndetshme dhe të ëmbla si pjepri.

Trupi i vajzës përshkruhet: *si peshk, si ngjalë, si gdheni në thep, si selvi, si lis me rrema. Syrin e ka si rrushi, gojën e vogël si kuti, qafën si pëllumbi, bash si hana po ban dritë, ballë përvjelun si jahudi, tulet e saj si me hëngër mish sugari, si me hëngër mish oqiçi, si me hëngër mish kapreçi. Dashuria e saj e pamatë, sipas djalit është: pors i rrushi, po m'kokrron, pors i mollën po m'kafshon, si bostani po m'flegron, si fërliku po m'rrotullon, sikur ujku po m'kap e s'më lshon.*

Enumeracionet: Në këngën *N'atë bjeshkë ku dalin çikat: Aty rriten dredhëzat, boronicat/ Aty ku dalin nuset/ Rriten mjedrat, bozhuret/ Atje ku dalin plakat/ Rriten therrat dhe kaçat.*

Inversioni: Zhvendosja e fjalëve në fjali ka si qëllim të theksojë atë që është më e rëndësishme, aty bie edhe theksi logjik: *E bardha bjeshkë, e zeza jetë, trashë e majë i ka bjeshka, del e ndiej kumonet sot, rritu çikë, nana ty t'pastë, hajd bre çikë, ti dert mos kie, lot për faqe u kanë shkue.*

Përsëritjet: *N' vekë me kanë, po dal e rri/ N' vekë me kanë, po dal n' oborr, I kam t'jaranit, s'më shkojnë dam/ I kam t'jaranit, t' djalit t'ri, Po i qëndis mestet jaranit/ Po i qëndis mestet për nam, Ma ka lanë, besa burri i parë/ Ma ka lanë çikën amanet, N'gryka-n'gryka konkan marrë/ N'gryka-n'gryka kokan shtrëngue.* Te kënga *Ti bari e un' bareshë përsëriten vargjet: Ohoho hojdado/ More djalë i dadës – o.* Po kështu edhe te kënga *Ku e kalove verën sivjet? përsëriten vargjet: O gojfil i malit!, O moj lulja e allit.*

Pyetjet retorike: *Ku e kalove verën sivjet? Ku don çikë me bjeshkue? Cila bjeshkë doket më e mira? Ku ma le lum dada besën? Çka kanë lulet në Sylbicë? Po çka ke, bardhokë, lum dada? Si nuk dole një natë me fjetë?*

Përfundime

Këto këngë janë monument me vlerë të artit popullor të bytyçasve dhe nga pikëpamja estetike janë me dimensione universale, sepse janë me dimensione të shpirtit njerëzor. Jetojnë në lidhje të ngushtë me njeriun, si mbështetëse ideore e shpirtërore në momentet më të rëndësishme.

Bazën e dashurisë së krijimit të familjes, kënga e gjen në vetitë morale të dy të rinjve, duke zbuluar pikëpamjet e një sociologjie realiste në jetën e tyre. Në këto këngë janë pasqyruar aspirata të bytyçasve, mendimi filozofik dhe social kolektiv, shija kolektive. Sferat e jetës që trajtohen në këto këngë kanë rëndësi shoqërore, kulturore, ekonomike, gjuhësore dhe psikologjike.

Dashuria është domosdoshmëri për afrimin dhe bashkimin e të rinjve, të djalit me vajzën, me momente hera-herës sensacionale. Këto nxiten nga dashuria e vajzës dhe aksionet e djalit, i cili për të realizuar qëllimin e vet kalon aq shumë pengesa sa që arrin të pamundurën. Fantazia e të dashuruarve nuk ka kufi. Këngët trajtojnë përjetimet nga kontaktete e shkurtra, nga ledhatimet, nga bisedat, nga sinjalizimet, afërsia fizike e shpirtërore, në një konfiguracion gjeografik të caktuar: *në bjeshkë, në kullota, te gurra e ujit, te mrizi, në rudinat e bjeshkës, në shtrungë ku milen delet*. Kurdoherë vajza ka aromë dashurie, kurse djali ka vetitë e trimit. Këto janë dy mundësitë kryesore për bashkim, dy komponente të ardhmërisë. Si djali, edhe vajza janë të barabartë - në rreziqe, në sakrifica, asnjëri nuk ka privilegj të veçantë. Në përgjithësi dashuria shprehet, pohohet drejtpërdrejt. Në momente të veçanta shprehet edhe me anë të nëntekstit poetik të vargjeve. Djali dhe vajza, pavarësisht nga paragjykimet e kohës, nuk kanë frikë të shprehin hapur dashurinë. Duke vepruar kështu ata kanë përjetuar momente gëzimi e hidhërimi, besimi e pesimizmi, por që ia kanë dalë në shumicën e rasteve. Ndjenja e fortë e pikëllimit, e cila shkaktohet nga mosrealizimi i dashurisë kapërcehet edhe pse me pengesa e vështirësi të mëdha. Hera-herë malli, indi i pandashëm i këtyre këngëve është përvëlues, ngashërues si motiv i përjetshëm, që bën të humbet qetësia, të arratiset gjumi e në ndonjë rast të humbë shpresa se do të realizohet bashkimi i tyre.

Figuracioni artistik gjithmonë është krijuar me mjete reale nga jeta e mjedisit, ku mbizotëron profesioni i blegtorit. Veçori e këtyre këngëve

është zhvillimi dinamik i gjuhës së tyre, zhvillimi i vazhdueshëm që lidhet me vetë përvojën gjuhësore.

Në këto këngë ka rima të shumëllojshme, asonanca, ritëm dinamik, këngët janë monokolonë, mbizotëron vargu karakteristik popullor tetërrokësh. Realizimi i ideve, i veprimeve dhe i qëndrimeve është i mundshëm vetëm me anë të stilit dhe figurshmërisë së tij.

Në vitet 1945-1990, te këto këngë kanë hyrë elemente të reja, të lidhura me zhvillimet politike, ekonomike, sociale, psikologjike të kohës.

Dashuria lind në punë, forcohet nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta për të rritur të ardhurat. Puna rrit mirëqënien, harmoninë, lumturinë në familje, largon mërzinë, vesin dhe nevojën.

Djali dhe vajza janë në garë me njëri-tjetrin. Kjo shpreh emancipimin e shoqërisë shqiptare në vitet '80 dhe '90.

Këta konkurrojnë me njëri-tjetrin si të barabartë. Gëzimi i punës është gëzimi i jetës – ky është lajtmotivi i këtyre këngëve. Duke punuar së bashku e njohin më mirë njëri-tjetrin dhe vendimet që marrin janë më të pjekura, më të qëndrueshme. Propozimi vjen natyrshëm, pa ndrojtje, pa pompozitet:

*“Kur ta korrim grurin sivjet,
çikë me ty kam pasë një dert.
Djalë i ri boll mirë po thue,
Po çfarë derti ke pasë me mue?”*

Ata e kanë kuptuar se e duan njëri-tjetrin e nuk ka nevojë për ligjërata të gjata e fjalë të mëdha. Pasi të kryejnë punët e stinës do të shpallin fejesën e do të martohen. Vjeshta, me plot prodhime e fruta të pjekura – është finalizimi i kësaj dashurie. Vajza krahasohet me kumbullën. Vetë titulli i këngës e shpreh këtë - *Kumbull, moj në kumbull shkove*. Ajo është si lulja e bardhë e kumbullës në pranverë. Në brezaret plot kumbulla punon, dashurohet. Fjala e saj është e ëmbël si kumbulla e zezë tropojane. Nënteksti i këngës është i qartë. Ashtu siç është e njohur në gjithë vendin, bile edhe jashtë tij për vlerat e saj kumbulla tropojane ose dardane (nga Kosova e ka prejardhjen), e njohur është edhe vajza bytyçase me bukurinë e saj fizike e shpirtërore.

Lulëzon kumbulla, lidh frytin, piqet dhe gëzon sofrat tona. Ashtu rritet e hedh shtat vajza si sorkadhe, martohet dhe mbush shtëpinë me fëmijë, me gëzimin e jetës. Jeta vazhdon rrjedhën e saj.

Bibliografia

Berisha, Rrustem. *Stili dhe figuracioni i poezisë popullore shqiptare* (Prishtinë: IAP, 1986).

Berisha, Rrustem. *Vëzhgime për poezinë popullore* (Prishtinë: Rilindja, 1987).

Demaliaj, Skënder. *Këngë të mbledhura në Krahinën e Bytyçit, dorëshkrim*, arkivi personal.

Guiraud, Pierre. *Stilistika* (Sarajevë: Veselin Masleša, 1964).

Neçaj, Gjon. *Haiku i bjeshkëve* (Elbasan: Egnatia, 2009).

Papleka, Ndoc. *Lirikë nga Tropoja* (Tiranë: Globus R, 2001).

Sako, Zini. *Këngë popullore dashurie* (Tiranë: Instituti i Folklorit, 1965)

Vinca, Nuhi. *Lirika popullore shqiptare në regjionin e Strugës* (Shkup: Flaka e vëllazërimit, 1992).

Zojzi, Rrok. *Ndamja krahinore* (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2020).